MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN KUMAN , FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Kuman, Fier, me objekt: **"**Mbi Vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, zbatimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike e lejeve të ndërtimit, lejeve te shfrytëzimit, administrimit të aseteve, vlerësimit për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, legalizimin e shtesave në ndërtime, dhënien me qira të objekteve pronë publike, masat për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimi i Auditit të brendshëm " dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.22 , datë 20.02.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 431/7, datë 12.03.2012, dërguar **z. Rajmond Plaka,** Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Sektori i taksave vendore të marrë masa:

- për realizimin dhe rritjen e të ardhurave vendore si dhe për planifikimin e saktë të disa taksa vendore të cilat kanë rezultuar me rezerva si taksa e pastrimit familjar etj.
- për kontrollin në terren ndaj subjekteve fizike që vet deklarojnë xhiro vjetore minimale dhe për kontrollin e subjekteve që nuk janë verifikuar asnjëherë si dhe atyre që kanë ngarkesë të njëjtë për çdo vit.
- për kompletimin e dosjeve me dokumentacionin e duhur sidomos me dokumentin e hipotekës për efekt të llogaritjes taksës së ndërtesës.

Menjëherë

2. Zyra e Taksave Vendore të rakordojë me Policinë e Komunës për të marrë masa për vjeljen e vlerës **4,806,100 lekë** prej të cilave:

- në 30 subjekte në vlerën 282,100 lekë;
- për taksën e tokës bujqësore nga 1.356 fermerë për vlerën 3,680,000 lekë;
- për taksën e ndërtesës nga popullata në vlerën 126,000 lekë;
- për tarifë pastrimi nga popullata në vlerën 700,000 lekë;
- për tarifë pastrimi nga biznesi në vlerën 18,000 lekë, në zbatim të nenit 49 "Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin", pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998. (*sipas listës bashkëlidhur).*

Menjëherë

3. Sektori i Ujësjellësit të zbatojë vendimin e Këshillit të Komunës nr. 42, datë 01.12.2010 "Për realizimin e të ardhurave sipas tarifës të konsumit të ujit të pijshëm nga familjarët", në shumën prej 136,200 lekë.

Menjëherë

4. Sektori i Ujësjellësit të lidhi kontratat me familjarët dhe subjektet private për konsumin e ujit.

Vazhdimisht

5. Zyra e Financës në bashkëpunim me Zyrën e Taksave të kontabilizoj debitorët nga biznesi që nuk kanë shlyer detyrimet.

Menjëherë

6. Zyra e Financës të dërgojë për regjistrim në ZVRPP, objektet ndërtimore që aktualisht janë të pa regjistruar, në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pasurisë paluajtshme shtetërore dhe transformimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" dhe UKM nr. 3, datë 18.07.2002.

Menjëherë

7. Kryetari i Komunës ti kërkojë firmës të ndërtimit [redacted] sh.p.k. të kryejë riparimin e defekteve të konstatuara, në tenderin "Rikonstruksion i Rrugës Vidhishtë-Drizë" e cila është brenda garancisë të punimeve, në të kundërt të zbatohen sanksionet e kontratës nr. 105/11, datë 01.07.2009.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore detyrimi ***343,400 lekë*** dëm ekonomik, përkatësisht:

1. Vlera prej *117,000 lekë*, nga firma [redacted] sh.p.k, për punime të pa kryera në tenderët me objekt:

-" Rikonstruksion i rrugës "Vidhishtë -Drizë" 65,000 lekë

"Ndërtim asfaltim rruga Kuman - Vidhishtë" 52,000 lekë, në kundërshtim me kontratën nr. reference 105/11 datë 01.07.2009 dhe nr. 101/7/2, datë 10.08.2009 në zbatim të nenit 8 e 11, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, dhee UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

Menjëherë

2. Vlera prej 76,000 lekë, nga firma [redacted]. për punime të pa kryera në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i Rrugës Lagja e Re - Vidhishtë", në kundërshtim me kontratën nr. reference 106/11/2, datë 10.08.2009 dhe nenet 8 e 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, dhe UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

Menjëherë

3. Vlera prej 55,100 lekë, nga firma [redacted] sh.p.k. dhe [redacted]" për punime të pa kryera në tenderin me objekt: "Ndërtim ujësjellësi Kuman-Vidhishtë", në kundërshtim me kontratën nr. reference 101/7/2, datë 10.08.2009 dhe nenit 8 e 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, dhe UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"

Menjëherë

4. Vlera prej 94,750 lekë, nga firma [redacted] sh.p.k. për punime të pa kryera në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Vidhishtë- Kuman", me vlerë prej 51,300 lekë - "Rikonstruksion i shkollës i 9-vjeçare Luar" me vlerë prej 43,450 lekë**,** në kundërshtim me kontratën nr. reference 103/8, datë 30.09.2009 dhe nr. 150/11, datë 05.05.2011 dhe nenit 8 e 11, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe

disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të Kreu III-të , nenet 15 e 16, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 "Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, meqenëse në Komunën Kuman nuk është ngritur struktura e INU, bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar i propozojmë Këshilli të Qarkut Fier të kërkojë nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik pranë Këshillit të Qarkut marrjen e masës administrative "gjobë" për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve të ndërtimit si më poshtë:

1. [redacted] me cilësinë e mbikëqyrëses të punimeve, gjobë në masën 50,000 lekë, për dëmin ekonomik shkaktuar në vlerën 141,000 lekë, në tenderët me objekt :

- rikonstruksion i rrugës Vidhishtë – Drizë";
- rikonstruksion i rrugës Lagja e Re - Vidhishtë";
- për mos kryerjen e detyrës për verifikimin e zërit të punimeve, ku rezultuan me diferencë më pak në 2 tender punimesh duke i shkaktuar buxhetit të komunës një dëm ekonomik prej 141,000 lekë, në kundërshtim me kontratën e punimeve nr. reference s'ka, datë 06.05.2009 dhe nenet 7 dhe 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar si dhe moszbatimin e kreut të parë, pikat 1/2, 3, 3/1, kreu II pika 1/b, c, ç, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", si dhe pikën 4 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"

1. [redacted]**,** me cilësinë e kolaudatorit të punimeve, gjobë në masën 50,000 lekë, për dëmin ekonomik shkaktuar në vlerën 141,000 lekë, në tenderët me objekt:

-" Rikonstruksion i Rrugës Vidhishtë – Drizë"
- "Rikonstruksion i Rrugës Lagja e Re - Vidhishtë"
-"Ndërtim asfaltim rruga Kuman - Vidhishtë"
-mos kryerjen e detyrës për verifikimin e volumit faktik ku rezultuan me diferencë më pak në 3 tendera punimesh duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik prej 193 000 lekë, në kundërshtim me kontratën e punimeve dhe nenet 7 dhe 11 të ligjit nr, 8402 datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit".
-kreun e parë, pikat 1/2, 3, 3/1, kreu II pika 1/b, c, ç, të udhëzimit KM nr. 2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".
-pikën 4 të udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës" i ndryshuar dhe Kontratat individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës, që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000"Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

***"Vërejtje me shkrim", p*ër** :

1. [redacted] me detyrë përgjegjës i Zyrës të Urbanistikës.

- Ka pranuar dosjet të cilat kanë mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

- Dokumentacionin fotografik, këto kryesisht për punimet e padukshme, të cilat janë objekt diskutimi për saktësinë e punimeve, në kundërshtim me Kreun I-rë pikën 8.3 të UKM nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".
- shkresat për njoftim nga drejtori i punimeve për mbikëqyrësit të punimeve, për pasaktësitë, mospërputhjet dhe mungesën e të dhënave në projekt. Në kundërshtim me Kreun II-të pika 2.1, të UKM nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".
- librat të instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë. Në kundërshtim me Kreun III-të pika 3, të UKM nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".
- Regjistrin e kontabilitetit
- Deklaratat teknike të punimeve
- Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet e rezultatet e tyre.
- Të gjitha dosjet e prokurimeve janë pranë zyrës të arkivës, por janë të pa protokolluara dhe të pa dorëzuara me proces verbal, në kundërshtim me ligjin 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat".

2[redacted] me detyrë Jurist dhe Kryetari i njësisë së prokurimit.
- Dosjeve të prokurimit nuk u ka bashkëngjitur fletën e inventarit, ku të pasqyrohej i gjithë dokumentacioni që administrohej në dosje.
- në dosjet e prokurimeve dhe dosjet e tenderit, (Zbatimit) që administroheshin në zyrën e protokoll-arshivës te Komunës, në asnjë nga dosjet e prokurimit nuk kishin bashkëngjitur regjistrin e Procedurave të Prokurimit Publik, dokument standard i miratuar nga APP, veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, " Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 12, pika 3.
- për dorëzimin e ofertave për **13 t**enderët e kontrolluar, njësia e prokurimit e ka mbyllur më par në kohë sesa afati kohor i përcaktuar në dokumentet e tenderit për dorëzimin e ofertave.

3. [redacted]. me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Taksave.
- nuk ka realizuar të ardhurat nga taksat e tarifat në shumën ***4,806,100 lekë*** prej të cilave:
- nga 30 subjekte në vlerën 282,100 lekë;
- nga taksa e tokës bujqësore për 1.356 fermerë në vlerën 3,680,000 lekë;
- taksa e ndërtesës nga popullata në vlerën 126,000 lekë;
- tarifë pastrimi nga popullata në vlerën 700,000 lekë (nuk është mbledhur fare nga zyra e taksave).
- tarifë pastrimi nga biznesi në vlerën 18,000 lekë, në zbatim me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" ndryshuar me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 neni 49 "*Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin"*, pika 1, dhe në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 (*sipas listës bashkëlidhur)*.

4. [redacted]**,** me detyrë përgjegjës i Ujësjellësit Kuman Fier.
- Nuk ka zbatuar vendimin e Këshilli Komunës nr. 42, datë 01.12.2010 "Për realizimin e të ardhurave sipas tarifës të konsumit të ujit të pijshëm nga familjarët", duke krijuar një dëm ekonomik në shumën ***136,200 lekë***
- nuk ka hartuar një evidencë për numrin e familjeve që kërkojnë të lidhin linjën për furnizim me ujë të pijshëm;
- nuk ka kontrata të lidhura ndërmjet komunës me konsumatorët;

- nuk disponohen procesverbale për lidhjen e nyjeve furnizuese dhe në rast të shkëputjes për banorët që largohen nga vendbanimi, trajtuar në kreun e V-të, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Piro Imeraj,Sotir Kozdine dhe Antoneta Zotaj . Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT